

Workshop Discussions | MINUTES

Analize dhe Rekomandime:

Impakti i integritit European në Njësitë e Qeverisjes Vendore në Shqipëri

Ekspertë: *Aida GUGU (SCO-A)*

datë | 7/5/2014 10:30 AM | vendi Shkoder

Organizuar nga:	DLDP	Moderator:	Valbona KARAKAÇI
Formati i takimit:	Workshop me kryetarë të NJQV-ve ku shtrihet dldp, përfaqësues të DoPA, ASPA dhe MoEI/CBC	Përmbledhja:	Erida DOBRUSHI
Pjesëmarrës:	18		

çështjet e ngritura

propozime

Impakti i Integritit European në Njësitë e Qeverisjes Vendore në Shqipëri

Mungesa e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet pushtetit vendor dhe pushtetit qendror ka sjellë edhe kufizimin e mundësive të aftësisë dhe përfitimit të njësive të qeverisjes vendore nga fondet e BE-së. Eksperiencat dhe historitë e suksesshme që NJQV-të kanë në bashkëpunimin dhe përfitimin e asistencës teknike të programeve të zhvillimit nga OJF dhe donatorë që kanë fokus zhvillimin e komunitetit dhe qeverisjes vendore tregojnë se ekziston vullneti për të bashkëpunuar, por mungojnë instrumentat për ta zhvilluar dhe konkretizuar ndërveprimin me pushtetin qendror.

Komisioni Evropian ka ngritur disa zyra informacioni pikërisht për ti ardhur në ndihmë pushtetit vendor në njohjen e këtij procesi, por këto zyra nuk mundësojnë konsultimin dhe asistencën e nevojshme për NJQV-të.

Pushteti vendor duhet të gjejë mekanizma "atraktiv" përballë pushtetit qendror në mënyrë që procesi i konsultimit ndërmjet këtyre dy niveleve të qeverisjes të bëhet funksionale.

Gjithashtu, pushteti vendor duhet të gjejë format dhe të përdor masa shtrënguese ndaj pushtetit qendror, në mënyrë që të imponojë përmbushjen e interesave të tij në raport me kërkesat dhe axhendën europiane, e cila në nivel lokal faktikisht ka dështuar.

Ka ardhur koha që NJQV-të të bëhen të vetëdijshme për kompetencat dhe aktivitetin e tyre në raport me legjislacionin e përafër të BE-së.

Ka mungesë informacioni nga NJQV-të në këtë aspekt, fakt që nuk justifikon dhe nuk ndihmon në radhë të parë vet NJQV-të. Njësitë e Qeverisjes

	<p>Vendore duhet të tregohen shumë më aktive dhe të detëdijshme për rëndësinë dhe përgjegjësitë që do ketë në implementimin e legjisllacionit të përafuar të BE-së.</p>
<p>Çështjet e brendshme që lidhen me disa funksione për menaxhimin e territorit dhe harmonizimin e sistemit në tërësi ndërmjet NJQV-ve janë parakusht për t`ju afruar axhendës së BE-së.</p> <p>BE nuk dikton mënyrat apo mekanizmat se si vendet që aspirojnë për tu antarësuar duhet që ti adresojnë këto çështje, por japin mundësinë e njohjes së praktikave të mira në vendet anëtare.</p>	<p>Reforma terriotoriale-administrative dhe strategjia për decentralizimin e pushtetit vendor duhet të identifikojnë mekanizma të cila i japin zgjidhje çështjeve të brendshme lokale dhe rajonale, të cilat lidhen me bashkëpunimin ndër-vendor dhe që janë në funksion të zhvillimit lokal dhe rajonal.</p> <p>Në këtë kendvështrim, duhen propozuar struktura informuese dhe koordinuese nga qeverisja qendrore, në mënyrë që procesi i njohjes së politikave europiane të fillojë sa më shpejt dhe qeverisja vendore të ketë mundësi ti përshtatet në kohën e duhur kushteve dhe mundësive që ofron axhenda europiane.</p>
<p>Duhet përfaqësim aktiv nga shoqatat e bashkive/komunave: Ajo që mbetet problem është bashkëpunimi dhe ngritja e zërit të përbashkët nga NJQV-të për shkak të interesave politike.</p>	<p>NJQV-të duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ka organizimi dhe përfaqësimi nëpërmjet shoqatave. Shoqatat e bashkive dhe komunave mund dhe duhet të luajnë një rol shumë më aktiv në informimin e pushtetit vendor, për rolin e tyre në axhendën europiane.</p>
<p>Problem mbetet ngritja e kapaciteteve në nivel vendor: qeverisja vendore po përballlet me humbjen e nivelit të kapaciteteve të administratës vendore.</p>	<p>Kushtet dhe termat e marrëdhënieve të punës që ofron sot pushteti vendor është në disfavor të ruatjes së kapaciteteve njerëzore profesionale.</p> <p>Është e domosdoshme që të ketë asistim dhe trajnim të vazhdueshëm, sidomos në nivel sektorial të administratës vendore, si dhe garanci ligjore për qëndrueshmërinë e administratës vendore.</p> <p>Gjithashtu, pushteti vendor duhet të ketë hapësira dhe bashkëpunim për të përfituar nga asistenca/konsulenca e nivelit qendror në përgatitjen dhe implementimin e projekteve strategjike për zhvillimin lokal.</p>

Problemet lokale janë të njëjta dhe zgjidhja e tyre nuk vjen nga mbështetja politike. Ky fakt, më shumë e bashkon pushtetin vendor sesa e ndan.

Qeverisja vendore duhet të fillojë të ndikojë në informimin dhe lobimin e komunitetit për mundësitë dhe oportunitetet që sjell axhenda europiane.

Closing: 13: 30 PM

